

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 17, DATË 16.1.2019, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E SHOQËRIVE TË TJERA SHTETËRORE OSE
PRIVATE, TË RËNDËSISHME PËR INTERESIN E PUBLIKUT, PËR SHKAK TË
NATYRËS SË BIZNESIT, MADHËSISË OSE NUMRIT TË PUNËMARRËSVE
TË TYRE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “ç”, të pikës 23, të nenit 2, të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009, “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 17, datë 16.1.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në nënndarjen III, “Klasifikimi për shkak të madhësisë së biznesit”, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në shkronjën “a”, vlera “1.500.000.000 (një miliard e pesëqind milionë) lekë” zëvendësohet me “2.500.000.000 (dy miliardë e pesëqind milionë) lekë”;

b) Në shkronjën “b”, vlera “750.000.000 (shtatëqind e pesëdhjetë milionë) lekë” zëvendësohet me “1.250.000.000 (një miliard e dyqind e pesëdhjetë milionë) lekë”;

c) Në shkronjën “c”, fjalët “...të kësaj pike...” zëvendësohen me “...të kësaj nënndarjeje...”.

2. Shkronja “a”, e nënndarjes IV, “Klasifikimi për shkak të numrit të punëmarrësve të tyre”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Belinda Balluku

Botuar ne F.Zyrtare 112/2023

Dale nga shtypi me 28.07.2023